**AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE KONFISKUARA**

# REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE VITI 2026

| Nr. Rend. | Data e kërkesës | Objekti i kërkesës | Data e përgjigjes | Përgjigje | Mënyra e përfundimit të kërkesës | Tarifa |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| 01 | 03.03.2026 | Përshëndetje. Në vijim të komunikimit me ju si institucion dhe duke ju falënderuar për kthim përgjigjjet e deritanishme jeni të lutur të më vendosni në dispozicion të dhënat sa vijon:<br><br>1. Jeni të lutur të më nisni të detajuar listën e 1092 pasurive, provave, mjeteve motorike, pasuri të paluajtshme të pamarra ende në dorëzim nga Agjensia, sipas zërave përkatës<br>2. Çfarë vlere financiare kanë në total?<br>3. Çfarë është vendosur me qytetarin e kërcënuar nga pronari për lirimin e ambientit të marrë me qira? | 13.03.2026 | Përshëndetje, referuar kërkesës tuaj ju informojmë si më poshtë vijon:<br>- Bashkëlidhur gjeni tabelën me të dhënat përkatëse lidhur me listën e 1092 pasurive që nuk janë marrë ende në dorëzim nga Agjencia.<br>-Këto pasuri nuk janë të vlerësuara financiarisht, pasi aktualisht nuk administrohen nga AAPSK.<br>- Në lidhje me qytetarin e kërcënuar nga pronari për lirimin e ambientit të marrë me qira, pas referimit të rastit dhe ndërhyrjes së autoriteteve kompetente, palët kanë arritur mirëkuptim ndërmjet tyre dhe situata është normalizuar. Qytetari ka vijuar marrëdhënien e tij kontraktore me Agjencinë dhe nuk janë konstatuar episode të tjera të ngjashme.<br>-Në lidhje me aktakuzat për pasuri nën sekuestro /të konfiskuara, që janë të përfituara nga korrupsioni, shpërdorimi i detyrës apo tenderat, bëjmë me dije | Me email | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 4. Sa prej këtyre pasurive nën sekuestro/të konfiskuara janë të përfituara nga korrupsioni, shpërdorimi i detyrës apo tenderat? | | Agjencia nuk ka në dispozicion informacion për pasuritë që ende nuk janë marrë në dorëzim. | | |
| 02 | Mars 2026 | Duke ju falenderuar përzemërsisht për ndihmën dhe bashkëpunimin që po tregoni, konfirmoj se e mora emailin. Por ndërkohë, në lidhje me pasuritë e pamarra në dorëzim;<br><br>1. Cilat janë propozimet që ka bërë Agjensia për të mundësuar marrjen e pasurive nën dorëzim?<br>2. Cilat janë arsyet e mosmarrjes në dorëzim të pasurive si rasti i aseteve të Flamur Hakes dhe të Ervis Martinaj, apo mosmarrje në dorëzim të aseteve apartamente në Vlorë dhe Sarandë? | Prill 2026 | Përshëndetje,<br><br>Në vijim të kërkesës suaj, ju informojmë si më poshtë:<br><br>• Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, në zbatim të detyrimeve ligjore, ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për marrjen në dorëzim dhe administrimin e pasurive, përfshirë bashkëpunimin me institucionet përgjegjëse. Sqarojmë se Agjencia vepron vetëm mbi bazën e vendimeve gjyqësore të komunikuara zyrtarisht dhe të ekzekutueshme, dhe nuk ka kompetencë të propozojë marrjen në administrim të pasurive që nuk i janë kaluar ende. | Me email | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | • Në lidhje me mosmarrjen në administrim të pasurive të shtetasit Flamur Haka, sqarojmë se, me vendimin nr. 1532, datë 24.09.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, është vendosur pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 53, datë 20.03.2024 të Gjykatës së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Në këto kushte, në zbatim të këtij vendimi, pasuritë në fjalë nuk janë marrë në administrim nga ana e Agjencisë.<br><br>• Sa i përket pasurive të shtetasit Ervis Martinaj, rezulton se çështja është në proces verifikimi dhe ndjekjeje sipas procedurave ligjore përkatëse.<br>• Lidhur me pasuritë e tjera, sqarojmë se administrimi i tyre është i lidhur drejtpërdrejt me statusin juridik të vendimeve gjyqësore përkatëse. Në rastet kur vendimet janë të formës së prerë dhe nuk ekzistojnë pengesa ligjore për ekzekutimin | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | e tyre, Agjencia vijon me procedurat për marrjen në administrim të pasurive. Në të kundërt, në rastet kur ka vendime pezullimi apo procese gjyqësore në vijim, administrimi i këtyre pasurive nuk mund të realizohet deri në një vendimmarrje përfundimtare nga organet kompetente.<br><br>Duke ju falenderuar për interesimin, | | |
| 03 | 08.04.2026 | Kërkesë për informacion publik mbi vendimmarrjen për zhvendosjen e mbetjeve të dyshuara si të rrezikshme- Nga Media Amfora<br>Në vijim të një kërkese për informacion drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, nga përgjigjja e kësaj të fundit rezulton se vendimmarrja dhe<br>procedurat për zhvendosjen dhe ruajtjen e kontenierëve të sekuestruar me mbetje të dyshuara si të | 15.04.2026 | Përshëndetje, Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, paraqitur në bazë të legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit, ju bëjmë me dije si më poshtë: 1. Zhvendosja e kontenierëve në zonën e Shënavlashit është kryer nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, në përputhje me ligjin nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara”, në kuadër të ushtrimit të funksioneve për ruajtjen dhe administrimin e këtyre pasurive.<br>2. Vendimi për zhvendosjen e kontenierëve është mbështetur në aktin administrativ të datës 26.02.2026 të | Me email | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | rrezikshme në Durrës janë në kompetencë të institucionit tuaj.<br>Në këtë kuadër, në bazë të ligjit për të drejtën e informimit, kërkojmë informacion mbi:<br>1. Kush ka marrë vendimin për zhvendosjen e kontenierëve në zonën e Shënavlashit?<br>2. Në cilin akt administrativ mbështetet ky vendim (urdhër/vendim/shkresë) dhe cila është data e tij?<br>3. Cilat institucione apo struktura kanë qenë të përfshira në këtë vendimmarrje?<br>4. Cilat kanë qenë arsyet dhe kriteret për përzgjedhjen e kësaj zone për vendosjen e kontenierëve?<br>5. Çfarë masash sigurie dhe monitorimi janë parashikuar për këto materiale gjatë qëndrimit në këtë zonë? | | Autoritetit Portual Durrës, në të cilën është kërkuar bashkëpunimi i institucionit tonë për lirimin e hapësirës.<br>3. Në këtë proces kanë qenë të përfshira edhe strukturat e Policisë së Shtetit, përfshirë Oficerin e Policisë Gjyqësore, në kuadër të garantimit të ligjshmërisë dhe sigurisë gjatë zbatimit.<br>4. Përzgjedhja e zonës së Shënavlashit është bërë për arsye logjistike dhe operacionale, për shkak të afërsisë me vendndodhjen e zhvendosjes, aksesit të përshtatshëm për transport dhe mundësisë për të garantuar kushtet e nevojshme të sigurisë dhe administrimit.<br>5. Gjatë qëndrimit në këtë zonë, kontenierët janë objekt i masave të vazhdueshme të sigurisë dhe monitorimit, duke përfshirë ruajtjen nga Policia e Shtetit, praninë fizike të strukturave përgjegjëse, si dhe mbikëqyrjen me sisteme kamerash sigurie.<br>Ju faleminderit, | | |

<table>
<tr>
<td>4.</td>
<td>08.07.2026</td>
<td>Revista Monitor, në bazë të ligjit nr. 190 dt. 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, neni 3, kërkon të informohet në lidhje me:<br><br>1.Deri tani, në total sa ka arritur deri tani numri i objekteve (vetëm atyre rezidenciale) të sekuestruara nga Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK)?<br><br>2. Sa llogaritet vlera e pasurive te paluajtshme per banim te sekuestruara?<br><br>3.Fondi i pronave të sekuestruara si ndahet në numër dhe vlerë sipas qyteteve ?</td>
<td>17.07.2026</td>
<td>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, në bazë të ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:<br><br>Numri total i objekteve (vetëm atyre rezidenciale) të sekuestruara që janë në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) është 345.<br><br>Vlera e përgjithshme e pasurive të paluajtshme për banim të sekuestruara: 4,625,079,438.86 lekë.<br><br>Numri dhe vlera e objekteve rezidenciale të sekuestruara sipas qyteteve paraqiten në tabelën e mëposhtme.<br><br>
<table>
<tr><th>Qyteti</th><th>Nr</th><th>Vlera (lekë)</th></tr>
<tr><td>Fier</td><td>22</td><td>109,067,990.00</td></tr>
<tr><td>Vlorë</td><td>83</td><td>391,854,876.00</td></tr>
<tr><td>Elbasan</td><td>12</td><td>89,809,108.00</td></tr>
<tr><td>Kavajë</td><td>9</td><td>28,210,740.00</td></tr>
</table>
</td>
<td>Me email</td>
<td>Pa pagesë</td>
</tr>
</table>

<table>
<tr>
<td></td>
<td></td>
<td>4.A mund të na shpjegoni procedurën ligjore që ndiqet deri në vendosjen e masës së sekuestros mbi një pasuri? Cili është roli i SPAK, i Gjykatës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe i Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK)? Kur hyn në administrim një pronë nga AAPSK dhe a vendoset sekuestrimi vetëm me vendim gjykate?</td>
<td></td>
<td>
<table>
<tr><td>Durrës</td><td>30</td><td>407,614,390.00</td></tr>
<tr><td>Lezhë</td><td>8</td><td>3,785,600.00</td></tr>
<tr><td>Sarandë</td><td>14</td><td>62,318,050.00</td></tr>
<tr><td>Himarë</td><td>2</td><td>Ska sipërfaqe të përcaktuar</td></tr>
<tr><td>Delvinë</td><td>1</td><td>3,584,500.00</td></tr>
<tr><td>Berat</td><td>14</td><td>34,385,012.00</td></tr>
<tr><td>Kamëz</td><td>2</td><td>11,741,600.00</td></tr>
<tr><td>Cërrik</td><td>1</td><td>2,367,706.00</td></tr>
<tr><td>Pogradec</td><td>2</td><td>5,693,590.00</td></tr>
<tr><td>Shkodër</td><td>3</td><td>13,208,080.00</td></tr>
<tr><td>Tiranë</td><td>142</td><td>3,461,438,196.86</td></tr>
<tr><td>Total</td><td></td><td>4,625,079,438.86</td></tr>
</table>
Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) ushtron veprimtarinë e saj në zbatim të Ligjit nr. 34/2019 "Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara", i cili përcakton kompetencat e Agjencisë në administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.
Vendosja e masës së sekuestros mbi një pasuri nuk bën pjesë në kompetencat e AAPSK-së. Procedura për vendosjen e kësaj mase rregullohet nga Kodi i Procedurës Penale dhe legjislacioni i posaçëm në fuqi.
</td>
<td></td>
<td></td>
</tr>
</table>

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) merr një pasuri në administrim, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 34/2019 *"Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara"*, i ndryshuar. Konkretisht, neni 16 i këtij ligji parashikon marrjen në dorëzim të pasurisë së sekuestruar në bazë të vendimit të gjykatës/urdhërit të prokurorit, ndërsa neni 17 rregullon marrjen në dorëzim të pasurisë së sekuestruar me urdhër të lëshuar nga organi administrativ kompetent, sipas fushës së zbatimit të këtij ligji.<br><br>AAPSK administron dhe mirëmban pasurinë e sekuestruar, duke siguruar ruajtjen dhe, kur është e mundur, rritjen e vlerës së saj ekonomike.<br><br>Për sa i përket rolit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) dhe të Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (GJKKO), sqarojmë se roli dhe kompetencat e tyre janë të përcaktuara nga legjislacioni që rregullon organizimin dhe funksionimin e këtyre institucioneve. AAPSK nuk është institucioni kompetent për të dhënë informacion që lidhen me rolin dhe veprimtarinë e SPAK | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | dhe GJKKO mbi procedurat hetimore apo gjyqësore që çojnë në vendosjen e masës së sekuestros. Për marrjen e informacionit, Ju mund t'u drejtoheni institucioneve përkatëse ose faqeve të tyre zyrtare.<br><br>Shënim: Për pasuritë në qytetin e Himarës është e pamundur të përcaktohet vlera duke qënë se vendimi për sekuestrimin e tyre nuk ka të dhëna lidhur me një nga komponentët kryesor të vlerësimit të pasurive, sipërfaqen e tyre. | | |
| 5. | 20.07.2026 | Kërkesë për informacion nga Top Channel. Bazuar në të drejtën ndërkombëtare për informim si dhe Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Ligji Nr. 119/2014, datë 18.09.2014 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet Zyrtare”.<br><br>**1. Sa prona janë të sekuestruara në tërësi?** | 03.08.2026 | Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, në bazë të ligjit nr.119/2014, “ Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:<br><br>Në kuadër të ekzekutimit të vendimeve të gjykatave apo urdhrave të prokurorit për sekuestrimin e pasurive, rezultojnë gjithsej 3,618 pasuri të sekuestruara, nga të cilat 2,500 pasuri janë marrë në dorëzim nga AAPSK-ja, ndërsa 1,118 pasuri ende nuk janë marrë në dorëzim. | Me email | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **2. Sa prej tyre janë duke u administruar nga shteti dhe vijojnë funksionin e tyre?**<br><br>**3. Sa është përfitimi financiar nga menaxhimi i këtyre pasurive?**<br><br>**4. Sa objekte janë aktualisht me qira? A mund të kemi një listë të tyre?** | | Duke iu referuar pasurive të sekuestruara të marra në dorëzim rezultojnë të jenë 2500 pasuri në administrim nga shteti.<br><br>AAPSK rrit me 31.7% të ardhurat nga administrimi në gjashtëmujorin e parë të vitit 2026. AAPSK vijon të shënojë rezultate pozitive në administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Gjatë periudhës janar–qershor 2026, të ardhurat nga qiradhënia arritën në vlerën 131.5 milionë lekë, ose 31.7% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025. Ky rezultat pasqyron administrimin efikas të aseteve dhe angazhimin e AAPSK për të gjeneruar të ardhura në mbështetje të institucioneve ligjzbatuese dhe projekteve me interes publik.<br><br>Bazuar në të dhënat e administruara dhe pas verifikimit të të dhënave përkatëse, rezulton se gjatë periudhës janar - qershor 2026, janë nënshkruar 245 kontrata qiraje. Lista përmban informacion konfidencial me të dhëna personale për individët dhe nuk mund t’ua vendosim në dispozicion. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **5. Kush i shfrytëzon objektet, pronari legjitim apo persona të tjerë të përcaktuar nga institucioni juaj?**<br><br>**6. Sa objekte nuk janë shfrytëzuar dhe tashmë janë në gjendje të degraduar?**<br><br>**7. Sa është kostoja e mirëmbajtjes së këtyre objekteve?** | | Pronari legjitim mund të shfrytëzojë objektin vetëm me urdhër të prokurorit, në rastet kur ai provon se nuk disponon një objekt tjetër për banim. Në rastin e personave të tretë, kontratat e qirasë lidhen vetëm pasi këta të fundit kanë paraqitur kërkesë për marrjen me qira të pasurisë dhe kanë plotësuar formularin përkatës, nëpërmjet të cilit deklarojnë se nuk kanë lidhje me subjektin ndaj të cilit është vendosur masa e sekuestrimit të pasurisë.<br><br>Pasuritë e pashfrytëzuara përbëhen nga objekte të cilat nuk janë dhënë me qira, si dhe nga pasuri të vendosura në përdorim të institucioneve të caktuara, në zbatim të vendimeve të Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar. Lidhur me numrin e objekteve në gjendje të degraduar, nuk mund të jepet një shifër e saktë, pasi gjendja fizike e secilës pasuri përcaktohet rast pas rasti, bazuar në dokumentacionin dhe kartelën përkatëse të pasurisë.<br><br>Lidhur me koston e mirëmbajtjes së pasurive, sqarojmë se nuk është e mundur të përcaktohet një vlerë e përgjithshme, pasi shpenzimet e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | mirëmbajtjes ndryshojnë sipas karakteristikave dhe gjendjes së secilës pasuri. Kostoja përkatëse përcaktohet rast pas rasti dhe evidentohet në kartelën individuale të pasurisë. | | |
| | | **8. A ka pasur raste që janë ngritur padi ndaj jush për shkak se objekti i sekuestruar e ka humbur vlerën që kishte në momentin e sekuestrimit?** | | Po, ka pasur një rast në të cilin është ngritur padi ndaj AAPSK-së me pretendimin se pasuria e sekuestruar ka humbur vlerën që kishte në momentin e sekuestrimit. Në përfundim të gjykimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit. | | |
| | | **9. Sa prona janë të konfiskuara në tërësi? A mund të kemi një listë të këtyre objekteve?** | | Në kuadër të ekzekutimeve të vendimeve të gjykatave apo urdhër të prokurorit për konfiskimin e pasurive rezultojnë se janë në total 1033 pasuri. Lista përmban informacion konfidencial me të dhëna personale për individët dhe nuk mund t'ua vendosim në dispozicion. | | |
| | | **10. Sa prej tyre janë shitur në ankand online? Cila është procedura e ndjekur?** | | AAPSK nuk zhvillon ankande online. Nga verifikimi në lidhje me ankandet e kryera rezultojnë të jenë 16 ankande.Të gjitha | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **11. A ka raste që prona është blerë nga i njëjti person të cilit i ishte sekuestruar? Cilat janë ato raste?**<br><br>**12. A ka pasur kontestime të kësaj procedure?** | | procedurat e shitjes në ankand zhvillohen në përputhje me Ligjin nr. 9874, datë 14.02.2008, "Për ankandin publik", si dhe me VKM nr. 888, datë 14.12.2016, "Për miratimin e rregullave të organizimit dhe zhvillimit të ankandit publik". Procedurat zhvillohen duke respektuar parimet e ligjshmërisë, transparencës, barazisë së pjesmarrësve dhe konkurrencës, sipas kuadrit ligjor në fuqi.<br><br>AAPSK ushtron kompetencat e saj në përputhje me Ligjin nr. 34/2019 "Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara" dhe Ligjin nr. 10192/2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë". Në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, gjatë procedurave përkatëse respektohen kërkesat ligjore për shmangien e konfliktit të interesit, duke u plotësuar deklaratat përkatëse të konfliktit të interesit nga personat e përfshirë në proces. AAPSK nuk ka dijeni dhe nuk mban përgjegjësi në lidhje me këtë çështje. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **13. Nëse i referohemi faqes tuaj online shikojmë ankande për skrap, naftë apo bagëti. Po ankande të tjera nuk janë zhvilluar?** | | Nuk ka pasur kontestime.<br><br>Në kuadër të garantimit të transparencës dhe informimit të publikut, AAPSK publikon të gjitha ankandet në faqen zyrtare të institucionit. Në ankand janë nxjerrë pasuri të luajtshme të tipit skrap, naftë, dele (gjë e gjallë) të cilat kanë degraduar për shkak të periudhës se gjatë që kanë qenë në konfiskim dhe eficenca me e mirë është që të kryhen procedurat e ankandit. | | |